



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 50/19
Prishtinë, më 03.04.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Ali Lajçi, Mërgim Lushtaku, Jelena Bontic, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Arbërie Nagavci, Dardan Molliqaj dhe Blerim Kuçi.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Krasniqi - Sekretar i Përgjithshëm i Administratës së Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Administratës së Kuvendit të Kosovës, Istret Azemi - Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa të Administratës së Kuvendit të Kosovës.

Pjesëmarrës tjerë: Sami Kurteshi – Deputet, Yllka Gashi - Praktikante nga LDK, Klarisa Nuredini-Praktikante nga KDI, Emirjeta Vllahu - Gazetare nga BIRN, Arbëresha Shpati - Gazetare nga KLAN KOSOVA, Albena Bislimi- Gazetar nga EO, Ylli Sokoli - Praktikant, Hëna Rexha - Praktikante, Arbenita Marmullaku - Gazetare nga RTK nga Radio.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljeta Krasniqi, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli, Doruntina Pireva - Praktikante, Sofie Tahiri - Praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetari i Komisionit (tutje Kryetari i Komisionit).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Votimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018;**
- 3. Votimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020 - 2022;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit: Konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Votimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018;

Kryetari i Komisionit: Sqaroi se në mbledhjen e fundit kemi shqyrtuar Raportin vjetor të shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2018, por që nuk kemi pasur korum për votim.

Kryetari i Komisionit konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, Komisioni me 4 vota për, 1 votë Abstenim dhe 1 votë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni i rekomandoi Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018.

3. Votimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018

Kryetari i Komisionit: Sqaroi se në mbledhjen e fundit kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018, por që nuk kemi pasur korum për vendimmarrje.

Kryetari i Komisionit konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, Komisioni me 5 vota Për, 2 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër.

Rekomandim

Komisioni i rekomandoi Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të shpenzimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018.

4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020-2022

Kryetari i Komisionit: Theksoi se Grupi Punues i përbërë nga Blerim Kuçin dhe Ali Lajçin në bashkëpunim me administratën e Kuvendit kanë hartuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020-2022.

Ali Lajçi: Në takimet me grupin punues kemi diskutuar planifikimet e buxhetit për tri vitet e ardhshme. Ajo që ka qenë temë e rëndësishme për diskutim është projekti Villa Gërmia, për të cilën është lënë të diskutohet në Komision.

Ismet Krasniqi: Në pikën e dytë rreth shpenzimeve, sipas të dhënave që janë vlerësuar, buxheti në vitin 2020 do të jetë diku rreth 12 milionë e 47.000 euro, vitin 2021, 11 milionë e 834 mijë euro dhe në vitin 2022, 11 milionë e 195.000 euro. Sipas kategorive totale, totali i pagave 8 milionë e 600 mijë euro, i njëjti edhe dy vitet në vijim. Shërbimet dhe mallrat 212 mijë, shpenzime komunale 241 mijë, subvencione 140,000 për tre vite, shpenzime kapitale për 2020 1 milion e 550 mijë, për vitin 2021, 1 milion e 190 mijë dhe në vitin 2020, 501,000.

Kryetari i Komisionit: Shpenzimet kapitale janë e vetmja kategori që po zbritet ndër vite, ndërsa shumica e deputetëve dhe zyrtarëve po ankohen për mungesë të hapësirës në Kuvend. Po më intereson me ditë a është bërë ndonjë planifikim për krijimin e hapësirave apo zyreve për punë për deputetët? Jemi i vetmi institucion në Kosovë që deputetët nuk kanë zyre.

Ismet Krasniqi: Shpenzimet kapitale për tre vitet e ardhshme parashohin rënie sepse këto investime të planifikuara gjatë viteve 2019-2021, do të realizohen kurse për vitin 2022 parashikohen të mbesin disa investime më specifike. Sa i përket hapësirave, sipas informacioneve jozyrtare është planifikuar që Presidenca të lëshojë hapësira dhe do të kemi afro 25 zyra në dispozicion, që kanë nevojë të pajisen me zyra dhe inventarë. Këto hapësira do të shpërndahen sipas numrit të deputetëve të cilat nuk janë kryetar të komisioneve ose shefa të grupeve parlamentare që kanë zyre.

Kryetari i komisionit: Sa i përket mjeteve financiare ne si Komision kishim pasur mundësi të akomodojmë brenda Kornizës Afatmesme, qoftë edhe për shtimin e objektit.

Naser Osmani: Ne kemi qenë disa herë të ngarkuar për zgjidhjen e problemit të Villa Gërmisë. Komisioni nuk mund të zgjidh këtë problem por ne vetëm i japim kahje përfundimit të saj. Edhe pse ka pasur tentativa që objekti t'i jepet dikujt tjetër. Këtë e zgjidh vetëm Kuvendi. Nëse nuk vendoset me perfundu projekti, atëherë duhet t'ia falim dikujt tjetër. Andaj është mirë të vendosim si nënkod për sigurim të sasisë së mjeteve nëse vendoset për të vazhduar me ndërtim.

Sami Kurteshi: Sa i përket zyreve për deputetë, në shumë parlamente që kam pasur rastin të shkoj dhe nga ajo që kam parë jemi i vetmi që nuk i'u siguron deputetëve dhoma. Është degraduar Kuvendi, mendohet se me rritjen e pagave zyra nuk është më e rëndësishme. Çështja tjetër që dua ta ngris është shtypje e dokumenteve në letër. Sipas një përlllogaritje rreth 4 milionë kopje kushtojnë 200 mijë euro. Mendoj se është shpenzim i kotë. Duke ditur se tashmë janë edhe laptopët në dispozicion për deputetë, do të duhej që shpërndarja e materialeve të bëhej në formë elektronike.

Ismet Krasniqi: Nga viti 2006 për projektin Vila Gërmia, kemi planifikuar shumë 1,000 euro për vit për mos shuarjen e projektit. Nga ju pres rekomandim për Kryesinë që për projekt të vendos Kuvendi. Për hapësira të reja, një ide e trajtuar ka qenë shtimi i një kati mirëpo nuk është marrë vendim pasi që është mendur se do të thuhet se Kuvendi po bënë mbindërtim. Për sa i përket letrës, me ndarjen e laptopëve, materialet në letër do t'i shpërndajmë vetëm për komisionin funksional të cilat bëjnë shqyrtimin e legjislacionit dhe materialet do të dërgohen në formë elektronike. Sa i përket Komisionit për ndihmë shtetërore, për pagat e anëtarëve të këtij komisioni është i ndarë buxheti në kuadër të buxhetit të Kuvendit, problem mbetet sistemimi anëtarëve të këtij komisioni dhe sigurimi i hapësirave që duhet bashkëpunuar me Ministrinë e Financave për ta zgjidhur këtë problem.

Sami Kurteshi: Ftesat për seanca është temë që dua ta diskutoj. Janë rreth 1000 ftesa që i gjej në kuti. Pse nuk bëhet edhe kjo punës përmes versionit elektronik.

Ismet Krasniqi: Ftesat janë inicim i pjesëmarrjes së deputetëve në seancë të cilët mund të mos kenë qasje, andaj u dërgohet edhe me leter edhe online.

Kryetari i komisionit konstatoi se pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, Komisioni me pesë vota Për, 2 Abstenime dhe asnjë Kundër, nxori këto

Rekomandime

1. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të miratojë Kornizën Afatmesme e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2020-2022 dhe të kërkohet nga Ministria e Financave, që e njëjta të inkorporohet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2020-2022.
2. Kryesia e Kuvendit, të iniciojë procedurat për krijimin e hapësirave të reja për punë për deputetët.
3. Kryesia e Kuvendit, të radhis për shqyrtim, në një të seancat plenare të Kuvendit, çështjen e Projektit “Qendra Administrative Protokollare në Gërmi”, në mënyrë që Komisioni për Buxhet dhe Financa, në varësi të vendimit të Kuvendit, të nxjerr rekomandimet lidhur me financimin e projektit në fjalë.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-101 për te Drejtën Ndërkombëtare Private dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**

Kryetari i Komisionit: theksoi se projektligji dhe as amendamentet nuk përmabjnë implikime buxhetore shtesë.

Kryetari i komisionit konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këto

Rekomandim

Projektligjin nr.06/L-101 për te Drejtën Ndërkombëtare Private dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmabjnë implikime buxhetore shtesë.

5. Të ndryshme

Naser Osmani: Sa për informim grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike, e ka përfunduar punën dhe ka bërë shumë ndryshime. Duhet kohë në përgaditjen e raportit nga stafi dhe grupi punues të ulet edhe njëherë për shqyrtimin e amendamenteve të propozuara dhe pastaj të procedojë raportin në komision. Në takimet e Grupit Punues kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, ndërsa nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit si sponsorizuese të projektligjit. Dy paragrafët e shtyar që kanë të bëjnë me mundësinë e bartjes së mjeteve financiare për grupet parlamentare të reja të formuara nga 6 apo më shumë deputetë, për shkak të qëndrimeve të ndryshme, i kemi lënë që të vendos komisioni. Po ashtu Grupi Punues, ka mbajtur një punëtori jashtë Kuvendit, ku me atë rast është shtruar një drekë pune, për të cilën Komisioni duhet të arsyetojë shpenzimet në mënyrë që të bëhet pagesa sipas rregullave në fuqi.

Kryetari i komisionit konstatoi se Komisioni me 6 vota Për, 1 Abstenim dhe Asnjë Kundër, miratoi mbulimin e shpenzimeve e krijuara për një drekë pune dhe pije në Punëtorinë e Grupit Punues të Komisionit të mbajtur më datë 26 mars 2019, me rastin e shqyrtimit të Projektligjit nr.06/L-137 për

ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:45.
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

Kryetari i Komisionit,

Lumir Abdixhiku